



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:256377

Datë: 04.02.2025

Numri i dokumentit: 06802852

CT.nr.52/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC-Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Çmega, në procedurën jo kontestimore për shqyrtimin e trashëgimisë së trashëgimlënëses M.R nga Rahovecit, sipas propozimit të propozuesit I.R nga Rahovecit, pas mbajtjes dhe përfundimit të seancave për shqyrtimin e trashëgimisë në datat 20.08.2024, 14.01.2025, 22.01.2025 dhe 03.02.2025, mori, ndërsa me datë 04.02.2025, përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

I. Pas të ndjerës M.R nga Rahovecit, e cili ka lindur me datë, ka vdekur me datë, në Rahovec, pa lënë testament, e as kontratë mbi mbajtjen e përjetshme, shtetase e Republikës së Kosovës, SHPALLEN për trashëgimtarë, në bazë të trashëgimisë e me obligim të kthimit të borxheve eventuale të trashëgimlënëses, deri në lartësinë e vlerës së trashëguar:

1. G.R, nga Rahoveci (biri i trashëgimlënëses), me numër personal:, në 1/20 pjesë në paluajtshmërinë me numër 00925-0, ZK Rahovec, vendi i quajtur “R. Sadiku”, me sipërfaqe prej 73m² dhe në 1/5 pjesë në paluajtshmërinë me numër 00929-0, ZK Rahovec vendi i quajtur “Ramiz Sadiku”, me sipërfaqe prej 135 m², sipas certifikatës së paluajtshmërive me numër 08-942/03-0047858/23, të datës 10.11.2023, lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, Zyra Kadastrale Komunale Rahovec.

2. Sh.R, nga Rahoveci (biri i trashëgimlënëses), me numër personal:, në 1/20 pjesë në paluajtshmërinë me numër 00925-0, ZK Rahovec, vendi i quajtur “R. Sadiku”, me sipërfaqe prej 73m² dhe në 1/5 pjesë në paluajtshmërinë me numër 00929-0, ZK Rahovec vendi i quajtur “Ramiz Sadiku”, me sipërfaqe prej 135 m², sipas certifikatës së paluajtshmërive me numër 08-942/03-0047858/23, të datës 10.11.2023, lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, Zyra Kadastrale Komunale Rahovec.

3. I.R, nga Rahoveci (biri i trashëgimlënëses), me numër personal:, në 1/20 pjesë në paluajtshmërinë me numër 00925-0, ZK Rahovec, vendi i quajtur “R. Sadiku”, me sipërfaqe prej 73m² dhe në 1/5 pjesë në paluajtshmërinë me numër 00929-0, ZK Rahovec vendi i quajtur “Ramiz Sadiku”, me sipërfaqe prej 135 m², sipas certifikatës së paluajtshmërive me numër 08-942/03-0047858/23, të datës 10.11.2023, lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, Zyra Kadastrale Komunale Rahovec.

4. N.R, nga Rahoveci (biri i trashëgimlënësës), me numër personal:, në 1/20 pjesë në paluajtshmërinë me numër 00925-0, ZK Rahovec, vendi i quajtur “R. Sadiku”, me sipërfaqe prej 73m² dhe në 1/5 pjesë në paluajtshmërinë me numër 00929-0, ZK Rahovec vendi i quajtur “Ramiz Sadiku”, me sipërfaqe prej 135 m², sipas certifikatës së paluajtshmërive me numër 08-942/03-0047858/23, të datës 10.11.2023, lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, Zyra Kadastrale Komunale Rahovec.

5. Z.R, nga Rahoveci (biri i trashëgimlënësës), me numër personal: (letërnjoftim të Republikës Federale të Gjermanisë), në 1/20 pjesë në paluajtshmërinë me numër 00925-0, ZK Rahovec, vendi i quajtur “R. Sadiku”, me sipërfaqe prej 73m² dhe në 1/5 pjesë në paluajtshmërinë me numër 00929-0, ZK Rahovec vendi i quajtur “Ramiz Sadiku”, me sipërfaqe prej 135 m², sipas certifikatës së paluajtshmërive me numër 08-942/03-0047858/23, të datës 10.11.2023, lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, Zyra Kadastrale Komunale Rahovec.

II. Detyrohen trashëgimtarët e shpallur G.R, Sh.R, I.R, N.R dhe Z.R që kësaj gjykate në mënyrë solidare t’ia paguajë taksën gjyqësore për shqyrtimin e trashëgimisë, në shumën prej 50.00 euro, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Në këtë gjykatë është iniciuar procedura e trashëgimisë pas vdekjes së trashëgimlënësës M.R nga Rahoveci, pasuria e të cilit është përshkruar në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata konform nenit 32 dhe 33 të Ligjit Nr.06/L-007 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr.03/L-007 të procedurës jokontestimore ka bërë njoftimin për iniciimin e procedurës së trashëgimisë dhe të njëjtin e ka publikuar në gazetën zyrtare me qëllim të njoftimit të trashëgimtarëve të tjerë që eventualisht nuk janë të përfshirë në dëshminë e vdekjes.

Gjykata gjatë procedurës dhe nga shkresat e lëndës ka vërtetuar se trashëgimlënësja ka pasur vendbanimin e fundit në Rahovec, dhe se kjo gjykatë ka kompetencë territoriale dhe lëndore për të vendosur lidhur me këtë çështje jokontestimore.

Gjykata me shikimin e Dëshmi – vdekjes së datës 23.11.2023 të lëshuar nga Komuna Rahovec vërtetoi faktin se trashëgimlënësja e pasurisë trashëgimore si në dispozitiv të këtij aktvendimi është M.R nga Rahoveci, e cili ka lindur me datë 20.05.1928, ndërsa ka vdekur me datë 23.01.2017, pa lënë testament, e as kontratë mbi mbajtjen e përjetshme. Prej trashëgimtarëve ka lënë djemtë: G.R, Sh.R, I.R, N.R dhe Z.R dhe vajzën K.M, e lindur R.

Sipas propozimit për shqyrtimin e trashëgimisë gjykata ka caktuar shqyrtimin gjyqësor me datë 20.08.2024, 14.01.2025 dhe 22.01.2025. Trashëgimtari G.R ka pranuar që të shpallet trashëgimtare në pasurinë e të ndjerës nënës së tij në pjesën sa i takon sipas ligjit, si dhe i ka pranuar pjesën që mund të i takojë nga heqja dorë eventuale e trashëgimtarëve të tjerë. Trashëgimtarëve të tjerë nuk ua ka kontestuar të drejtën e trashëgimisë. Trashëgimtari Sh.R ka pranuar që të shpallet trashëgimtare në pasurinë e të ndjerës nënës së tij në pjesën sa i takon sipas ligjit, si dhe i ka pranuar pjesën që mund të i takojë nga heqja dorë eventuale e

trashëgimtarëve të tjerë. Trashëgimtarëve të tjerë nuk ua ka kontestuar të drejtën e trashëgimisë. Trashëgimtari I.R ka pranuar që të shpallet trashëgimtare në pasurinë e të ndjerës nënës së tij në pjesën sa i takon sipas ligjit, si dhe i ka pranuar pjesën që mund të i takojë nga heqja dorë eventuale e trashëgimtarëve të tjerë. Trashëgimtarëve të tjerë nuk ua ka kontestuar të drejtën e trashëgimisë. Trashëgimtarja K.M, e lindur R ka pranuar që të shpallet trashëgimtare në pasurinë e të ndjerës nënës së saj në pjesën sa i takon sipas ligjit, si dhe i ka pranuar pjesën që mund të i takojë nga heqja dorë eventuale e trashëgimtarëve të tjerë, ndërsa nga kjo pjesë ka hequr dorë në favor të vëllezërve të saj. Trashëgimtarëve të tjerë nuk ua ka kontestuar të drejtën e trashëgimisë. Trashëgimtari N.R ka pranuar që të shpallet trashëgimtare në pasurinë e të ndjerës nënës së tij në pjesën sa i takon sipas ligjit, si dhe i ka pranuar pjesën që mund të i takojë nga heqja dorë eventuale e trashëgimtarëve të tjerë. Trashëgimtarëve të tjerë nuk ua ka kontestuar të drejtën e trashëgimisë. Trashëgimtari Z.R ka pranuar që të shpallet trashëgimtare në pasurinë e të ndjerës nënës së tij në pjesën sa i takon sipas ligjit, si dhe i ka pranuar pjesën që mund të i takojë nga heqja dorë eventuale e trashëgimtarëve të tjerë. Trashëgimtarëve të tjerë nuk ua ka kontestuar të drejtën e trashëgimisë.

Andaj, gjykata duke u mbështetur në dispozitat e neneve 12, 119 dhe 135 të Ligjit për Trashëgiminë e Kosovës, si dhe në dispozitat e neneve 125, 128 dhe 162 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore me plotësim ndryshimet sipas Ligjit Nr.06/L-007 të datës 23.11.2018, ka vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

CT.nr.52/2023, me datë 04.02.2025

Bashkëpuntorja profesionale
Adelina Çmega

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa paraqitet nëpërmjet kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, Divizioni Civil.